

# BLUE TOOTH

*Thashetheme*  
*MADE IN ALBANIA*

Nr. 84

SUPLEMENT I PERJAVSHEM I GAZETA SHQIPTARE

## KOMBETARJA

NETET E NXEHTA  
TE GRUMBULLIMIT.  
KAZINO, ALKOOL E DISKO



TE FAMSHEM

18 VIP-at SHQIPTARE  
QE TUNDOJNE  
HOLLYWOOD-in

**CEKA i futet**  
**mik Pollos për**  
**Pajtim Lutajn**



**Fatos NANO**  
**thyen krahun**  
**në Llixha**



# Në shtrat me...

# BLEONA QERRETIN



**"Shtrati, vendi ku mund të fusësh brenda një njeri që të ndihesh rahat"**

**Jonida: Jam e**  
**zhgënjyer nga miq**  
**që kam dashur e**  
**respektuar**

**OLSA: Prej një viti**  
**jam shumë e lumtur**

**Elvis**  
**PUPA**  
**gjen Big**  
**Mamën**

**Eralda Hitaj, romancë**  
**me futbollistin Pema?**



# Orinda Huta:

## Dua të qëndroj larg medias

**T**ë gjithë e kanë vënë re mungesën e këngëtares Orinda Huta si në skenë ashtu edhe në revistat apo gazetatat rozë të përjavshme që dalin në treg. E ndërsa ka kaluar shumë kohë nga pjesëmarrja e saj e fundit në një festival muzikor, zbulojmë se Orinda do të vijë sërish pranë publikut dhe fansave të saj. Teksa e kontakton Orindën nuk zbulon asgjë, vetëm bën të ditur se materiali i saj muzikor do të dalë në treg pas tre javësh. Vetë këngëtarja shprehet: "Nuk dua të zbuloj asgjë më shumë. Të gjithë

do e shihni praninë time në ekran pas 3 javësh, me një produkt muzikor të cilin do e nxjerr në treg. Siç e keni vënë re i mungoj shtypit të shkruar prej kohësh dhe kjo është një zgjedhje e imja. Mendoj se kam bërë shumë mirë. Nuk dua të kem më kontakte me median. Kam rënë rehat". Prania e fundit e Orindës në një kompeticion muzikor ka qenë ai i dy sezoneve më parë në "Kënga Magjike". Pas kësaj këngëtarja preferoi të bënte paksa pushim, ndoshta për të ardhur së shpejti me një album.

# Rikthehet GERTA HETA

**P**as përfundimit të emisionit "Ne" në News 24, Gerta Heta zgjodhi Amerikën për të bërë pak pushim apo për t'u shpërndur nga sezoni i ngjeshur i punës. Por në fakt edhe atje nuk ka ndenjur pushim. Gjatë gjithë kohës ajo është marrë me këngën e saj më të fundit, një kompozim i vëllait të saj Flo-bari, i punësuar prej kohësh në Top Albania Radio. Kënga ka bashkëpunuar saj edhe videoklipin përkatës me të cilin Gerta ka punuar me shumë dashuri. E ka realizuar atë në Shtetet e Bashkuara dhe pritet që shumë shpejt ta promovojë atë në Shqipëri. Pasi kaloi më shumë se një muaj në kontinentin tjetër, Gerta pritet të vijë brenda këtij muaji në Tiranë ku dhe të tjera plane dhe projekte e presin në vijim.



AVNI ABASI - Aktor, producent arti  
 JAMES BELUSHI - Aktor  
 JOHN BELUSHI - Aktor  
 AGIM ÇOMA - Aktor  
 ARTON DJONBALAJ - Artist  
 ALBERT DACI - Vokalist në "Vanilla Ice"  
 NUHI DESTANI - Regjisor, producent dhe shkrimtar  
 JOSEPH J. DIOGUARDI - Kongresmen  
 KARA DIOGUARDI - Artiste  
 STAN DRAGOTI - Regjisor, producent  
 ELIZA DUSHKU - Aktore  
 GJEVALIN GEGAJ - Biznesmen  
 BILL KOVACH - Gazetar  
 DONALD LAMBRO - Gazetar  
 GJEKE MARINAJ - Poet, shkrimtar, gazetar  
 ARBEN PERLLESHI - Artist  
 REGIS PHILBIN - Moderator i emisioneve televizive  
 MASIELA LUSHA - Aktore

## 18 VIP-at shqiptarë që tundojnë HOLLYWOOD-in

**T**ë shumë janë shqiptarët që nëpërmjet talentit dhe profesionit të tyre, kanë zënë tashmë vend në skenat dhe ekranet e huaja, kryesisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Të gjithë jemi njohur me veprimtaritë e tyre duke ndjerë brenda vetes paksa krenari. Ne të "Bluetooth" nëpërmjet kësaj liste po tregojmë se cilët janë pikërisht 18 emrat e famshëm:



# Thashetheme